



**Republika e Kosovës – Republika Kosova**  
**Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia**  
**Izborni Panel za Žalbe i Predstavke**

**Anr.357/2013**

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Xhevdet Abazi kryesues, Muhamet Rexha dhe Ferit Osmani anëtarë, duke vendosur përkitazi me ankesën e Lëvizjes Vetëvendosje (LVV) dega në Prishtinë, paraqitur kundër subjektit politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK), dega në Prishtinë, për shkak të vendosjes së posterit mbi trafo të rrymës, për Zgjedhjet Lokale, në seancën e panelit të mbajtur me 31.10.2013, mori këtë:

**VENDIM**

**Refuzohet** si e pabazuar ankesa e Lëvizjes Vetëvendosje (LVV), dega në Prishtinë.

**Arsyetim**

PZAP-i, me datën 28.10.2013 ka pranuar ankesë nga LVV, në të cilën pretendohet se me datën 26.10.2013, te Santea në Prishtinë, anëtarë të subjektit politik PDK, kanë vendosur posterë të dy kandidatëve nga ky subjekt mbi trafo të rrymës. Parashtruesi i ankesës me këtë rast konsideron se është bërë shkelje e nenit 33 pika b, e LZP-së dhe neni 4.1 pika b e Rregullës Zgjedhore Nr.11/2013. Ankesës i ka bashkangjitur si provë fotografi si dëshmi.

PZAP-i, në kuptim të nenit 4 paragrafi 3 të Rregullave dhe Procedurave të PZAP-it, e informoi subjektin politik PDK, me datën 28.10.2013, për ankesën që është bërë ndaj këtij subjekti politik dhe ka kërkuar që të përgjigjet ndaj ankesës deri më datë 29.10.2013. Sipas afatit të caktuar PZAP-i pranoi përgjigjen e kërkuar nga subjekti politik, në të cilën konsideron se pretendimet e LVV-së, janë të pabaza lidhur me shkeljen e rregullave të përcaktuara në nenin 33 pika b të LZP-së, dhe se sipas të dhënave persona të pa identifikuar kanë vendosur posteret e kandidatës Florina Rugova, për asamblenë komunale të Prishtinës, nga radhët e PDK-së, me qëllim të dëmtimit të partisë, mirëpo edhe përkundër kësaj me të kuptuar këtë, aktivistet e PDK-së kanë hequr këta flamuj nga vendet për të cilat është ankuar LVV, thuhet në përgjigjen në ankesë të subjektit politik PDK.

PZAP-i, pasi që shqyrtoj ankesën gjeti se:

**Ankesa është e pabazuar**

Pretendimet e ankuesit në ankesën e tij se subjekti politik PDK ka vendosur posterat e dy kandidatëve nga ky subjekt mbi trafo të rrymës, PZAP-i i vlerëson si të pabazuara nga shkakut se nga fotografia e ofruar si dëshmi e cila gjendet në shkresat e lëndës nuk vërtetohet fakti ashtu siç pretendohet në ankesë, pasi që për asnjë moment nuk mund të identifikohet objekti i cili pretendohet, andaj pretendimet në ankesë konsiderohen si të përgjithshme, të pa argumentuara dhe të vërtetuara, në prova dhe dëshmi bindëse, dhe se një ankesë e tillë nuk mund të konsiderohet si e bazuar, prandaj në kuptim të nenit 118 paragrafi 1 të LZP-së, lidhur me ankesën e lart përmendur u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

**Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa në Prishtinë**

Anr. 357/2013 më datën 31.10.2013.

**Kryesuesi i Panelit  
Xhevdet Abazi**



***Udhëzim Juridik:***

PZAP nuk do t'i pranojë kërkesat për ri-apelim, sepse vendimet e tij do të konsiderohen si përfundimtare. Prandaj, siç parashihet në Nenin 118.4 të LZP-së, *ankesa në Gjykatën Supreme të Kosovës mund të paraqitet brenda njëzetekatër (24) orëve nga momenti i marrjes së vendimit nga PZAP-i, në rast se gjoha e përfshirë është më e lartë sesa pesëmijë (5, 000) Euro ose në rast se çështja prek një të drejtë themelore.*